

THE INCIDENCE OF PYOMETRA IN CATS IN THE REGION OF MALISHEVE INCIDENCA E PIOMETRËS NË MACE NË RAJONIN E MALISHEVËS

AVNI ROBAJ^{1*}, PASKAL GJINO², DRITON SYLEJMANI¹, KURTESH SHERIFI¹, AGIM REXHEPI, AFRIM HAMIDI¹

¹Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Departamenti i Mjekësisë Veterinare, Universiteti i Prishtinës, KOSOVË

²Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, Tiranë, SHQIPËRI
avni.robaj@uni-pr.edu

AKTET V, 1: 104-107, 2012

PËRMBLEDHJE

Studimi është rezultat i bashkëpunimit midis Fakultetit të Mjekësisë Veterinare të Tiranës dhe Departamentit të Veterinarisë pranë Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë të Prishtinës. Gjatë kësaj periudhe janë vizituar dhe trajtuar 58 mace me probleme të ndryshme. Metoda për përcaktimin e patologjive është realizuar me anë të kontrollit klinik, analizave të gjakut dhe të urinës, vaginoskopisë. Nga ky numër rastesh vetëm 5 mace u trajtuan për Piometër nga të cilat 3 mace u diagnostikuan me piometër të hapur dhe 2 mace me piometër të mbyllur. Piometra në mace është një patologji e shpeshtë e cila në shumë raste rrezikon edhe jetën e pacientit. Për këto arsye e rëndësishme është diagnostikimi i hershëm i kësaj patologjie dhe mjekimi kirurgjikal i saj. Piometra është patologji e shpeshtë në mace. Nga 58 mace të trajtuara mbi 2 vjet, 5 mace (8,62%), rezultuan me piometër.

Fjalët çelës: Mace, Mitër, Ovarioektomi, Piometër, Vezore.

SUMMARY

This study is outcome by the collaboration between Veterinary Medicine Faculty of Tirana and Veterinary Department in Agriculture Faculty of Prishtina. During this period has been visited and treated 58 cats with various of problems. Method for determination of pathologies was conducted by clinical control, blood and urine analysis and vaginoscopy. Only 5 cats from 58 cats has been treated for Pyometra where of 3 cats has been diagnosed with open pyometra and 2 cats with closed pyometra. The pyometra in cats is a frequent pathology which in many cases endanger the life of the patient. For these reasons is very important the early diagnostic of this pathology and its surgical treatment. Pyometra is frequent pathology in cats. Out of 58 cats treated over 2 years, 5 cats (8,62%) resulted with pyometra.

Key words: Cat, Ovariohysterectomy, Ovary, Pyometra, Uterus.

HYRJE

Infeksioni i mitrës në mace ndodh si pasojë e ndryshimeve hormonale (9). Pas estrusit, nivelet e progesteronit qëndrojnë të rritura për 8-10 javë dhe paretet e mitrës trashen duke e përgatitur mitrën për barsmëri (10). Infeksioni padyshim ndodh në fund të estrusit kur cerviksi ende nuk është i mbyllur plotësisht. Është konstatuar se edhe përdorimi i barnave me bazë progesteroni mund të shkaktojë infeksion të mitrës (1, 2, 4).

Mikroorganizmat depërtojnë në brëndësi të mitrës nëpërmjet qafës së saj e cila është porta hyrëse. Ajo qëndron e mbyllur gjatë estrusit. Kur qafa e mitrës hapet, mikrobet që gjenden normalisht në vaginë mund të hyjnë lehtësisht në mitër duke shkaktuar infeksionin e saj. Në kushte normale mjedisi rrethues nuk është i favorshëm për mbijetesën bakteriale. Kur mitra infektohet, muret trashen dhe bëhen cistike. Në këto kushte jo normale, muskujt e uterusit nuk mund të

kontraktohen siç duhet dhe për pasojë eksudati nuk mund të nxirret më jashtë. Piometra mund të vërehet në mace të reja dhe me moshë mesatare, por më shpesh ndodh pas moshës 6-10 vjeç. Periudha më tipike e shfaqjes së Piometrës në mace është rreth 1-2 muaj pas estrusit (3, 7). Piometra mund të jete e hapur apo e mbyllur (5). Shënjat klinike të maceve me Piometër ishin në vartësi të faktit nëse qafa e mitrës ishte e hapur apo jo. Në rastet kur kemi Piometër të hapur, qelbi mund të kullojë nëpërmjet vaginës dhe del jashtë. Kjo vërehet në lëkurë ose në qime nën bisht ose në shtrojet dhe pajisjet e saj, kur macja qëndron shtrirë. Temperatura, letargjia, anoreksia, depresioni, etj. mund të jenë ose jo të pranishme. Në qoftë se qafa është e mbyllur, qelbi që formohet nuk mund të rrjedhë jashtë. Grumbullimi në brendësi të mitrës mundëson tendosjen e abdomenit. Çlirimi i toksinave nga ana e mikroorganizmave bën të mundur përthithjen e tyre në gjak dhe krijimin e gjëndjes së intoksikimit të përgjithshëm (3), e cila maskon dhe rëndon së tepërmi infeksionin e mitrës (Piometrën). Macet me Piometër shumë shpejt sëmuren rëndë. Ato janë pa oreks, shumë apatike dhe shumë depresive. Në fazat e hershme të sëmundjes tek macet vërehen rrjedhje të lehta vaginale dhe jo shënja të tjera të sëmundjes.




Foto 1. Foto me piometër në mace

Në shumicën e rasteve sëmundja zbulohet me vonesë. Çdo mace e pasterilizuar dhe e sëmurë që pi sasi të mëdha uji gjithmonë dyshohet për Piometër (3, 6, 8). Kjo është veçanërisht e vërtetë kur vërehet rrjedhje vaginale ose zmadhim i barkut. Në stadi të avancuara të sëmundjes ndodh rritje e dukshme e rruazave të bardha të

gjakut si dhe rritje të globulinave (një tip proteine që prodhohet nga sistemi imunitar). Peshat specifike e urinës është shumë e ulët, kjo për shkak të efektit toksik të bakterieve në veshka.

MATERIALI DHE METODA

Studimi ynë u përqendrua në rajonin e Malishevës në mace që ishin paraqitur për vizitë në klinikën tonë. Janë vizituar mace me patologji të ndryshme si dhe janë grumbulluar të dhëna mbi praninë e piometrës. Sot në Kosovë ka një numër të konsideruar të praktikave veterinarë të cilat trajtojnë patologji të ndryshme të macet. Këtu u futën të gjitha macet pa përjashtim race apo moshe. Metoda për përcaktimin e patologjive është realizuar me anë të kontrollit klinik, analizave të gjakut dhe të urinës, vaginoskopisë. Janë marrë të dhëna për incidencën e piometrës në mace. Gjatë vizitave të maceve janë evidentuar dhe regjistruar mace me patologji dhe probleme të ndryshme por që nuk janë objekt i këtij studimi.

REZULTATE DHE DISKUTIME

Në mënyrë të përmbledhur karakteristikat klinike të maceve të vizituar dhe të trajtuar nga ana jonë para aplikimit të mjekimit jepen në Tabelën 1.

Mosha	3-10 vjeç
Pesha	2,5-9 kg
Sjellja e kafshës	Normale 15 ose 25,8% E qetë 18 ose 31,1% E eksituar 25 ose 43,1%
Gjendja e të ushqyerit	Normale 25 ose 43,1% Mangët 20 ose 34,4% Mbipeshë 13 ose 22,4%
Ngjyra e mukozave	Rozë 21 ose 36,2% Kongjestionuar 20 ose 34,4% Zbehtë 17 ose 29,3%

Tabela 1. Karakteristikat klinike të maceve para aplikimit të mjekimit

Gjendja e të ushqyerit në mace para mjekimit ishte normale në 25 mace (43,1%), e mangët në 20 mace ose 34,4%, dhe në 13 mace ishte mbi

peshë ose 22,4%. Ngjyra e mukozave ishte rozë në 21 mace (36,2%), e zbehtë në 17 mace (29,3%), dhe e kongjestionuar në 20 mace ose 34,4%. Sjellja e kafshës ishte e qetë në 18 (31,1%) raste, e eksituar në 25 (43,1%) raste dhe normale në 15 mace ose 25,8%. Ngjyra e mukozave ishte rozë në 21 raste ose 36,2%, e zbehte në 17 raste ose 29,3%, dhe e kongjestionuar në 20 raste ose 34,4%.

Mace me Piometër	5 ose 8,62%
Mace me pronar	5 ose 8,62%
Mace me Piometër të hapur	3 ose 5,17%
Mace me Piometër të mbyllur	2 ose 3,44%

Tabela 2. Karakteristikat e maceve me Piometër

Gjatë kësaj periudhe janë vizituar dhe trajtuar 58 mace me probleme të ndryshme. Nga ky numër rastesh vetëm 5 mace ose 8,62% u trajtuan për Piometër nga të cilat 3 mace ose 5,17% u diagnostikuan me piometër të hapur dhe 2 mace ose 3,44% me piometër të mbyllur.

Mosha	3-5 vjeç	6-8 vjeç	9-10 vjeç
Mace me Piometër	2 (3,44%)	2 (3,44%)	1 (1,72%)
Piometër e hapur	1 (1,72%)	2 (3,44%)	-
Piometër e mbyllur	1 (1,72%)	1 (1,72%)	-

Tabela 3. Frekuenca e Piometrës në mace në vartësi të moshës

Piometra në mace është shumë e shpeshtë në mosha të avancuara, në terma konkret në 3 mace ose 60% e tyre ishte rreth moshës 6-10 vjeq, dhe në 2 mace ose 40% e tyre ishte rreth moshës 3-5 vjeq. Ky rezultat shpjegohet me faktin se mungesa e riprodhimit, ndryshimet hormonale, dhe ulja e aftësisë mbrojtëse të kafshës në këtë moshë bëhen faktor i rëndësishëm për zhvillimin e piometrës. Në të gjitha rastet me piometër janë kryer analizat e gjakut dhe të urinës. Në 3 mace është konstatuar rritje e theksuar e numrit të leukociteve ndërsa në 2 mace kjo rritje e leukociteve ishte e moderuar. Në 2 mace me

Piometër të hapur manifestimi klinik mundësoi diagnostikimin e hershëm dhe trajtimin e përshtatshëm të tyre.

TREGUESIT HEMATOLOGJIKË	NORMALË	REZULTATET
Numrimi i eritrociteve	3-8 x 100.000/μL	3.6-7.3 x 100.000/μL
Numrimi i leukociteve	10-15 x 1000/μL	7-21 x 1000/μL
Hemoglobina	8-14 g %	7, 2-12 g%
PCV	24-45 %	21-33 %
Retikulocitet	0-1 %	0-2, 4 %
Neutrofilet %	55-60 %	60-84 %
Limfocitet	30-35 %	25-38 %
Monocitet x1000/ul	0-5 %	0-3 %
Eosinophilet x1000/ul	0-6 %	0-9 %
Bazofilet	0-1 %	0-1,5 %

Tabela 4. Treguesit hematologjikë normal dhe rezultatet e studimit në mace

TREGUESIT KIMIKË	NORMALË	REZULTATET
Glukoza	60 - 100 mg/dL	78 - 195 mg/dL
Alanine Transferaze (ALT)	1, 5 - 14 U/L	27-91 U/L
Total bilirubina	0. 0 - 0. 4 mg/dL	2-4, 2,5 mg/dL
Total proteina	5. 4 - 7. 8 gm/dL	6, 2 – 8, 4 gm/dL
Urea nitrogjen	20-30 mg/dL	16 - 39 mg/dL
Magnez	3, 12 mg/dL	2, 8 – 5, 12 mg/dL
Natrium	140 - 153 mmol/L	122 - 149 mmol/L
Chloride	106 - 118 mmol/L	115 – 128 mmol/L
pH	5-7	7. 2 - 7. 86

Tabela 5. Treguesit kimikë normal dhe rezultatet e studimit në mace

PERFUNDIME

Piometra është një patologji e shpeshtë në mace. Kështu nga 58 raste të trajtuara 5 ishin me

piometër (8,62%). Moshë e kafshëve që preken më shpesh nga piometra është pas moshës 6-10 vjeç. Periudha më tipike e shfaqjes së Piometrës në mace është rreth 1-2 muaj pas estrusit (3, 7).

Në rastet kur nuk dëshirohet riprodhimi i kafshëve të shoqërimit duhet të këshillohet sterilizimi i hershëm i tyre. Është konstatuar se edhe përdorimi i barnave me bazë progesteroni mund të shkaktojë infeksion të mitrës (1, 2, 4).

Raca dhe pesha e maceve nuk janë faktorë predispozues për lindjen e piometrës. Piometra e hapur në mace është patologji lehtësisht e diagnostikueshme dhe me mundësi të larta për mjekim medikamentoz dhe kirurgjikal. Piometra e mbyllur në mace paraqet vështirësi në vendosjen e diagnozës. Pas konstatimit të piometrës rekomandohet trajtimi kirurgjikal i menjëhershëm duke patur kujdes kryerjen e anestezisë së përgjithëshme. Trajtimi më i preferuar është heqja kirurgjikale e mitrës dhe vezoreve të maces.

Macet që diagnostikohen në fazë të hershme të sëmundjes janë candidate më të mira për operacion. Në këto raste operacioni teknikisht është shumë pak më i komplikuar se një sterilizim i zakonshëm. Fluidoterapia e shoqëruar me antibiotikë është mjaft e domosdoshme për trajtimin para dhe pas operacionit. Ka disa statistika ndërkombëtare të rëndësishme për këtë formë trajtimi.

Suksesi i trajtimit të Piometrës së hapur është 75-90%.

Suksesi i trajtimit të Piometrës së mbyllur është 25-40%.

Përqindja e rikthimit të sëmundjes është 50-75%. Mundësitë për shumëzim të suksesshëm pas trajtimit janë 50-75%, (6).

Rruga më e mirë e mundshme për të ruajtur shëndetin e maces dhe jetëgjatësinë e saj është

sterilizimi i tyre pas moshës 8-9 muaj dhe maksimumi 1.5 vjeç.

BIBLIOGRAFIA

1. Dr. Daniel A. Degner, board-certified veterinary surgeon-DACVS.
2. Infections of the Uterus Drs. Foster & Smith, Inc. Friday May 13, 2005.
3. jroskaj@petfooddirect.com
4. Lascelles, B. Duncan X.; Cripps, Peter J.; Jones, Al, Pearson Avril E., (1998), Efficacy and kinetics of carprofen an; Waterman administered preoperatively or postoperatively, for the prevention of pain in dogs undergoing ovariohysterectomy. *Veterinary Surgery*. Philadelphia, PA: W.B. Saunders Co. Nov./Dec. 1998, v. 27 (6), p. 568-582.
5. Leitner M, Aurich JE, Galabova G, Aurich C, Walter I. Histol Lectin binding patterns in normal canine endometrium and in bitches with pyometra and cystic endometrial hyperplasia. *Histopathol.* 2003 Jul;18(3):787-95. Clinic for Obstetrics, Gynaecology and Andrology, Institute of Histology and Embryology, University of Veterinary Medicine, Vienna, Austria.
6. Lofstedt, R.M.: The estrous cycle of the domestic cat. *Comp. Cont. Ed.* 4:52, 1982.
7. Marty Smith, DVM Pyometra & Infections of the Uterus *Drs. Foster & Smith, Inc.* Friday May 13, 2005.
8. Mastrocinque S, Fantoni DT. A comparison of preoperative tramadol and morphine for the control of early postoperative pain in canine ovariohysterectomy. *Vet Anaesth Analg.* 2003 Oct;30(4):220-8. Surgery Department, School of Veterinary Medicine and Zootechnic, University of Sao Paulo, Sao Paulo, Brazil.
9. Pyometra in cats-Pawprints and Purrs, Inc..